- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Forcë Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39**Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40**Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41**Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**Neni 42****Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e shihet të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 632-23-7721-5-2-1/C826

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 13 muaj . Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitim të sigurisë së ekzekutimit.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 dite pas nënshkrimit të kontratës sipas urdhërësës së menaxherit të kontratës..
	17.2	Përfundimi i të gjitha punëve: Kontrata planifikohet të përfundojë brenda 12 muajsh: për vitin 2023 – 60 ditë pune, për vitin 2024 – 80 ditë pune dhe në bazë të cilës periudhe edhe do të bëhen pagesat .

Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës .
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet me vendim të ZKA.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: nuk është e nevojshme
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 37 muaj nga përfundimi i punëve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shumën e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA
RENOVIMI I QERDHES SE KOMUNITETIT
LOKACIONI: GJAKOVË
INVESTITORI: KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË
VËREJTJE: Materialet e propozuara në përshkrim teknik dhe paramasë janë opcionale dhe pikë referimi për karakteristikat e materialeve që duhet të përdoren andaj të gjitha ato mund të zëvendësohen me materiale të prodhuesve tjerë me karakteristika të njëjta ose më të mira që duhet dëshmuar me certifikatat apo atestat e ofruara nga prodhuesit respektiv. Në të gjitha pozicionet përfshihet FURNIZIMI DHE MONTIMI/PUNIMI I ATIJ POZICIONI. TEK PASTRIMET, DEMOLIMET E GERMIMET TË PËRFSHIHET EDHE TRANSPORTI DERI NË DEPONI.

A	RENOVIMI I OBJEKTIT TE SHKOLLES EKZISTUES				
1	PUNËT NDËRTIMORE				
1.01	PUNËT PARAPREGADITORE				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1.01.01	Pergatitja e kompanise dhe bartja e paisjeve qe mundesojne realizimin e punimeve ne vendpunishte. Ne cmim te perfshihet dhe sigurimi i vendpunishtes per realizimin e punimeve ne menyren me te sigurte (rrethimi i punishtes).	komplet	1	50.00 €	50.00
1.01.02	Organizimi i punishtes dhe depove, furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriçimit të kantierit, vendosja e kontejnerit për zyrën e menaxhimit të projektit dhe vendosja e WC kabinave për nevojat e punëtorëve.	komplet	1	100.00 €	100.00
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.01					150.00 €

1.02	PUNËT E DEMOLIMIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1.02.01	Te behet demolimi i dyerve dhe dritareve nga materiali PVC dhe drurit, transporti i mbeturinave deri në deponinë e përcaktuar nga komuna deri 10km distance.	cope	25.00	5.00	125.00



1.02.02	Te behet demolimi i pllakave keramike ne dysHEME dhe gjithë perimetrit mureve te nyjeve sanitare duke perfshire gjithë shtresat deri ne bilok, si dhe transporti i mbeturinave ne deponin e caktuar nga komuna deri ne 10 km distance.	m ²	37.00	8.00	296.00
1.02.04	Te behet demolimi i lavamanëve ekzistues nga porcelani, transporti ,deponimi (deponimi) i mbeturinave deri në deponinë e përcaktuar nga komuna.	cope	3.00	15.00	45.00
1.02.05	Te behet demolimi i WC-Guacave, të behet transporti i tyre ne deponin e caktuar nga komuna deri ne 10km.	cope	3.00	15.00	45.00
1.02.07	Te behet demolimi i kulmit duke perfshire te gjitha shtresat deri ne plaken e betonit, ne cmim perfshihet pastrimi dhe transporti i mbeturinave deri ne deponin e caktuar nga komuna. Verejtje: Siperfaqja e kalkuluar eshte e llogaritur ne bazë, ndersa pjerrtesia e kulmit eshte 30%.	m ²	250.00	3.00	750.00
1.02.10	Te behet demolimi i laminatit ne kthinat e percaktuara sipas projektit, duke perfshire dhe lajsnet anesore. Ne cmim perfshihet transporti i mbeturinave ne deponin e caktuar nga komuna.	m ²	60.00	3.00	180.00
1.02.11	Të bëhet demolimi i të gjithë gypave te kanalizimit dhe ujesjellesit tek nyjet sanitare në të gjitha kthinat dhe transporti i mbeturinave ne deponin e percaktuar nga komuna.	komplet	1.00	50.00	50.00
1.02.13	Te behet demolimi i deres metalike tek pjesa e kthines teknike me dimension 100x210 cm, transporti i mbeturinave deri në deponinë e përcaktuar nga komuna deri 10km distance.	cope	1.00	50.00	50.00
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.02					1,541.00 €

1.03 PUNËT E SUVATIMIT					
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH



1.03.01	Furnizimi me material dhe suvatimi i sipërfaqeve të mbyllura me blloqe argjile, mureve të zhveshura nga pllakat e qeramikës deri në nivelin e plafonit me material të parapërzier si RÖFIX 510 (gëlqere+çimento+agregat) ose material të ngjashëm me trashësi 15 mm. Në çmim të përfshihet trajtimi paraprak i bazës me llaç sprucues RÖFIX 670 ose material të ngjashëm, listellat metalike për caktimin e trashësisë së llaçit, këndoret metalike, listellat dilatuese (anputzlesite) nga plastika me rretë armimi dhe shirit vetngjithës për dyer dhe dritare dhe mbrojtja e të gjitha pozicioneve të zdhuktharës me folie të PVC-së si dhe rjeta e PVC-së me fije qelqi për përforcimin e llaçit në çdo pjesë ku kalohet nga një material në tjetrin si blloqe-beton.	m ²	60.00	4.00 €	240.00 €
1.03.02	Furnizimi me material dhe patinimi i mureve me dy shtresa glet-masë RÖFIX 225 ose material të ngjashëm në të gjitha kthinat në nivelin e përdhësës dhe katit 1 të përcaktuara me projekt.	m ²	60.00	5.00 €	300.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.03					540.00 €

1.04	PUNËT E NGJYROSJES				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1.04.01	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e plafoneve dhe mureve të patinuara si dhe atyre të realizuara me pllaka gjips-kartoni me ngjyrë me bazë poliuretani e cila duhet të ketë aftësi të madhe të pastrimit. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me lyerje bazë/primer për enterier të përshtatshme për mure dhe pllaka gjipskartoni për reduktimin e shkallës së apsorbimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjithjes, etj.	m ²	550.00	2.50 €	1,375.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.04					1,375.00 €

1.05	PUNËT E TERMOIZOLIMIT, NIVELIZIMIT DHE VESHJEVE TË DYSHEMESË				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH




1.05.01	Furnizimi me material dhe punimi i dyshejesë nga laminati në të gjitha hapësirat e përcaktuara me projekt në të dy nivelet e objektit. Ngjyra e laminatit të përcaktohet në koordinim me organin mbikqyrës të caktuar nga investitori. Dysheja të punohet me shtresat në vijim: • Laminati me trashësi min.12mm, me ngjyrë dizajn të përzgjedhur në koordinim me organin mbikqyrës • Folie PE Në çmim përfshihet dhe montimi i lajsneve adekuata ne perimenter te te gjitha hapsirave te punuara me laminat. Lajset te jene me ngjyre te bardhe me lartesi h=7cm	m ²	40.00	16.50 €	660.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.05					660.00 €

1.06	PUNËT E HIDROIZOLIMIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1.06.01	Furnizimi me material dhe hidroizolimi i nyjeve sanitare në përdhese, hidroizolimi i shkallëve të hyrjes Në çmim duhet përfshirë hidroizolimin e dyshejesë në këto hapësira si dhe hidroizolimin e mureve perimetrike deri në lartësi 30 cm me hidroizolim të lëngshëm fleksibil dykomponentësh si Isomat Aquamat Flex të aplikuar në dy shtresa sipas udhëzimeve të prodhuesit. Poashtu në çmim duhet të përfshihet edhe aplikimi i pëlhurave të poliesterit ose rrjetave me fije qelqi në kënde për të penguar plasaritjen e hidroizolimit si dhe sanimi paraprak i të metave të sipërfaqes me Durocret, Rapicret ose Adiplast. Gjatë aplikimit të materialeve të respektohen të gjitha kushtet teknike dhe afatet e përcaktuara nga prodhuesi.	m ²	50.00	3.00 €	150.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.06					150.00 €

1.07	PUNËT E QERAMIKËS PORCELANIT GRANITIT KUARCIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH



1.07.01	Furnizimi me material dhe mveshja dyshemes e mureve deri në lartësinë e pllakës meskatëshe tek nyjet sanitare dhe hapësirat tjera të përcaktuara në projekt me pllaka të glazuara qeramike me dimensione, ngjyrë dhe teksturë/dizajn të përcaktuara në koordinim me organin mbikqyrës të përcaktuar nga investitori. Pllakat për mure duhet të jenë rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjitës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues si Ceresit CM11 Plus me fuga të gjera 3 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40. Në çmim të përfshihen listelat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut si Ceresit CS25.	m ²	100.00	16.00 €	1,600.00 €
1.07.03	Furnizimi me material dhe mveshja e shkallëve të jashtme tek hyrjet në objekt, mveshja e rampave/pjerrinave me pllaka graniti me sipërfaqe të vrazhdë të përpunuar me flakë. Të gjitha sipërfaqet horizontale, vertikale dhe ato të pjerrëta të vishen me pllaka graniti me trashësi 3 cm duke përfshirë edhe pjesët anësore të shkallëve deri në kuotën e përcaktuar në projekt, duke përfshirë caktimin me lartësi 10 cm në pjesët ku shkallët bashkohen me fasadën e objektit. Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	8.60	65.00 €	559.00 €
1.07.04	Furnizimi me material dhe ngjitja e pllakave të kuarcit për parapetin e të gjitha dritareve në pjesën brenda objektit. Pllakat duhet të ngjiten me ngjitës adekuat për kuarc dhe në anën e poshtme duhet të kenë të gdhendura kanalet për pengimin e rrjedhjes së ujit në drejtim të murit. Parapeti aty ku është e mundur të realizohet me 1 pllakë të vetme (pa vazhdime). Në çmim të përfshihet edhe mbyllja e fugave me shirita ekspandues hidroizolues dhe silikon sanitar. Trashësia 2 cm Gjerësia 25 cm (3 cm duhet të dalin jashtë murit) Ngjyra e bardhë	m ¹	17.00	22.00 €	374.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.07					2,533.00 €



1.08	PUNËT E ZDRUKHTARISË DYERT, DRITARET DHE ELEMENTET TJERA				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
	"Furnizimi transporti dhe montimi i Dritare PVC 80-85mm, me ngjyre te hirta me hapje dhe kiperim, Qelqi: Transparent Termopan 4x12x4x12x4 mm/Low-E + Argon Panell termolizolues: STADUR FB-4 Aluminium Sandwich element nga llamarinat e alumini me trashësi 1 mm me mbushje. Punimi i dritareve duhet të bëhet sipas skemës dhe pershkrimit. Prodhuesi (KBE, Aluplast, Trocal, Rehau apo ndonjë prodhues tjetër me karakter të ngjajshëm)."				
1.08.01	POS DO-01 - Derë dykrahëshe Dimensionet: 140x210 cm. Dizajni sipas skemës së zdrukthtarisë	copë	1.00	650.00	650.00
1.08.02	POS W-01 - Dritare PVC me roletë te jashtme. Dimensionet: 80x140 cm. Dizajni sipas skemës së zdrukthtarisë	copë	19.00	155.00	2,945.00
1.08.03	POS W-02- Dritare PVC me roletë te jashtme. Dimensionet: 60x60 cm. Dizajni sipas skemës së zdrukthtarisë	copë	1.00	100.00	100.00
1.08.04	POS W-03 - Dritare PVC me roletë te jashtme. Dimensionet: 80x80 cm. Dizajni sipas skemës së zdrukthtarisë	copë	1.00	120.00	120.00
	POS NS Furnizimi dhe montimi i ndarjeve nga PVC per nyjet sanitare me dimensione 340x170 cm, h=230 cm lartesi. Ne cmim perfshihet montimi i tri dyerve nga PVC me dime snione 70x210 cm, me te gjithë aksesoret e nevojshem. Dizajni sipas specifikimit të zdrukthtarisë.	copë	1.00	900.00 €	900.00 €
	Furnizimi dhe montimi i dyerve të brendshme për shumë qëllime. Materiali: HÖRMANN ose prodhues i cilësisë së njëjtë. Panelli: H3D Multi Purpose Door me mbushje nga leshi mineral - me trashësi 45 mm. Korniza e derës: dypjesëshe e kombinuar - nga korniza këndore me ankerë dhe dipla dhe kontra-kornizë Dorëzat: Inox - tipi i levës me kapak standard të zgjatur vertikal dhe profil për cilindër Mëntesha: 3 pjesësh për pesha të mëdha Ngjyra: E bardhë - Grey White RAL 9002. Mbyllësi hidraulik: Standard				
1.08.05	POS DO-02 - Derë njëkrahëshe Dimensionet: 90x200 cm. Dizajni sipas skemës së zdrukthtarisë	copë	2.00	300.00	600.00
1.08.06	POS DO-03 - Derë njëkrahëshe Dimensionet: 80x200 cm. Dizajni sipas skemës së zdrukthtarisë	copë	1.00	280.00	280.00



	Derë metalike . Korniza dhe struktura e derës metalike e punuar me shufra metalike katrore 5 x 5 cm qe perbejne kornizen dhe rrjeten me shtyllat cdo 1 m dhe trau i mesit shtangues horizontal. Mveshje e kornizes me llamarine 3 mm ne te dy anet dhe mbushje leshi mineral. Me goma izoluese EDPM perreth kornizes dhe sipërfaqe të rrafshta. Ngjyra e deres dhe profileve: E bardhë - RAL 9016. Dorëzat: jokorodive.				
1.08.08	POS DO-05 - Derë njekrahëshe me nje krahe statik Dimensionet: 100x210 cm. Dizajni sipas skemës së zdrukthtarisë	copë	1.00	450.00	450.00
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.08					6,045.00 €

1.09	PUNËT E FASADËS				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1.09.01	Furnizimi me material dhe punimi i fasadës termoizoluese të tipit StoTherm Vario nga prodhimet e kompanisë Sto ose sistem tjetër i ngjashëm i prodhuesve tjerë. Sistemi StoTherm Vario duhet të realizohet me shtresat si në vijim: • Ngjitës StoLevell Uni • Termoizolim Austrotherm EPS AF - t=10cm • Rrjetë Armimi Sto-Glasfasergewebe • Dy shtresa masë armuese StoLevell Uni • Lyerja bazë StoPutzgrund Nature • Liaç struktural organik Stoispollit Kratz K 2.0 mm • Ngjyrë akrilike Në çmim duhet të përfshihen të gjitha elementet tjera të nevojshme si profilet bazë, profilet këndore me rrjetë, profilet e PVC -së me pikore, kunjat përforcues të plastikës, rondelat termoizoluese, listellat dilatuese (anputzleiste) për dritare dhe dyer, shiritat ekspandues hidroizolues, profilet fleksibile për fugat e diletimit në fasadë, mbajtësit konzollë për dritare dhe materiale tjera sipas udhëzimeve të prodhuesit të sistemit termoizolues.	m ²	315.00	23.00 €	7,245.00 €



1.09.02	Furnizimi me material dhe punimi i cokllës dekorative nga prodhimet e kompanisë Sto ose sistem tjetër të ngjashëm të prodhuesve tjerë. Coklla termoizoluese duhet të realizohet me shtresat si në vijim: • Lyerja bazë StoPrep Contact • Ngjytës - masë hidroizoluese StoFlexyl • Termoizolim Austrotherm XPS 30 t=8 cm • Rrjetë Armimi - Sto-Glasfasergewebe • Dy shtresa masë armuese StoFlexyl • Lyerja bazë StoPutzgrund Nature • Llaç dekorativ shumëngjyrësh StoSuperlit K 2.0 mm Coklla duhet të realizohet nga kuota ± 0.00 deri në kuotën -0.50 ose rreth 15 cm thellësi nën nivelin e trotuarit të përfunduar për të shmangur ekspozimin nga uljet e mundshme të trotuarit. Në çmim duhet të përfshihen të gjitha elementet tjera të nevojshme si profilet bazë, profilet këndore me rrjetë, profilet e PVC -së me pikore, kunjat përforcues të plastikës, rondelat termoizoluese, shiritat ekspandues hidroizolues, profilet fleksibile për fugat e diletimit në fasadë, dhe materiale tjera sipas udhëzimeve të prodhuesit të sistemit termoizolues.	m ²	60.00	17.00 €	1,020.00 €
1.09.03	Furnizimi dhe montimi i pikoreve nga alumini me trashësi 2 mm për të gjitha dritaret e jashtme në fasadë. Gjerësia e pikores duhet të jetë së paku 28 me kusht që pikorja të jetë së paku 3 cm jashtë fasadës. Materiali: Alumin i plastifikuar Ngjyra: E hirtë - RAL 7016 Matt Në çmim të përfshihet edhe goma izoluese vetngjytese EPDM për mbyllje të fugës mes pikores dhe profilin të dritares, kapakët skajor, mbajtësit konzollë në distancë jo më të madhe se 50 cm dhe të gjitha mjetet tjera të nevojshme për fiksimin e pikoreve.	m ^l	17.00	21.00 €	357.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.09					8,622.00 €

1.10	PUNËT E KULMIT TË PJERRËT DHE LLAMARINËS				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
	Furnizimi dhe punimi i konstruksionit bartës dhe mbulesës së kulmit duke përfshirë trarët e kurorave, mbajtësit kryesor në nivele të ndryshme, brinjët (mahitë), dyshtemenë e punuar nga panelet OSB, listellat dhe kontralistellat, membrana difuzive, mbulesën nga tjegullat, kapakët e kulmarëve, mvëshjet këndore, ulluqet vertikale dhe horizontale, pikoret e mureve. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse si gozhda, vida dhe mjetet tjera të nevojshme.				



1.10.01	PUNIMI I KULMIT NGA TJEGULLAT / OBJEKTI I SHKOLLËS Furnizimi me material dhe punimi i kulmit me shtresat e definuara sipas projektit: · Tjegullat Tondach "Verlera" ose te ngjajshme me ngjyre te percaktuar nga mbikqyresi. · Kapak kulmari Tondach duke përfshirë dhe shiritin/membranën izoluese vetëngjitëse me vrima për ajrosje, dhe mbajtësat/distancerat metalik për ngritjen dhe nivelimin e traut të kulmari · Trajet drurit 10 x 12 cm · Listella 3 x 5 cm · Kontralistella 2 x 5 cm · Membrana 3 shtresore · Panel OSB 3 1.8cm · Termoizolim - Lesh Guri 15 cm. · Panel OSB 3 1.8cm (mbi leshin e gurit,mbeshtetur ne traje drurit ne dyshtemen e kulmit) Ne cmim te perfshihen te gjithë mjetet,aksesoret e nevojshem per lidhjen,fiksimin e trajeve te drurit,derrasave,listelave dhe tjegullave.	m ²	230.00	54.00 €	12,420.00 €
1.10.02	PUNIMI I KULMIT NGA TJEGULLAT / KTHINA TEKNIKE Furnizimi me material dhe punimi i kulmit me shtresat e definuara sipas projektit: · Tjegullat Tondach "Venera" ose te ngjajshme me ngjyre te percaktuar nga mbikqyresi. · Trajet e drurit 10 x 12 cm · Listella 3 x 5 cm · Kontralistella 2 x 5 cm · Membran 3 shtresore · Panel OSB 3 1.8cm Ne cmim te perfshihen te gjithë mjetet,aksesoret e nevojshem per lidhjen,fiksimin e trajeve te drurit,derrasave,listelave dhe tjegullave.	m ²	10.00	45.00 €	450.00 €
Furnizimi me material dhe punimi dhe montimi i elementeve të ndryshme nga llamarina e rrafshët e plastifikuar me trashësi 0.6 mm, me të gjitha elementet e nevojshme për sigurimin e padepërtueshmërisë së ujit si, pikore, hinka ujëmbledhëse, olluqe horizontale dhe vertikale etj.					
1.10.03	Pikore lugjeve në formë të shkronjës "V" e punuar nga llamarina e rrafshët e plastifikuar me trashësi 0.6 mm e montuar përgjatë lugjeve ne pjesen ku gershetohen kulmet. Gjerësia e shpalosur 30cm.	m ^l	40.00	12.00 €	480.00 €
1.10.04	Olluqe horizontale nga llamarina e rrafshët e plastifikuar, me prerje tërthore gjysëm harkore me diametër Ø150 mm në të gjitha anët e kulmit te objektit te shkolles dhe objektit te kthines teknike. Në çmim të përfshihet montimi me të gjithë mbajtësit e vendosur në distancë sipas standardeve si dhe kapakët skajor.	m ^l	76.00	12.00 €	912.00 €




1.10.05	Ullujë vertikale Ø100 mm për të katër kulmet të punuara nga llamarina e rrafshët e plastifikuar me trashësi 0.6 mm me ngjyrë të hirtë duke përfshirë pjesët fazonike (kthesat) si dhe mbajtësit dhe elementet e nevojshme për fiksime.	m ¹	48.00	12.00 €	576.00 €
1.10.06	Profile këndore nga llamarina e rrafshët e plastifikuar, e profiluar në formë "L" min.20+20 cm për të gjitha pikëtakimet/fugat e mbulesës së kulmit me muret vertikale. Skajet e elementit duhet të jenë të paluara dyfish për së paku 3 cm. Këndoret të përdoren për mbylljen e fugave/hapjeve në mes të mureve dhe mbulesës nga tjegullat. Gjerësia e shpalosur e llamarinës për këndore 50 cm. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, dhe tiplat për ankerim në mur në distancë rreth 50 cm me vida, fileta dhe goma izoluese për sigurimin e vrimave, si dhe izolimi i vijave kontaktuese me silikon rezistent ndaj ndryshimeve të temperaturës/për aplikim në eksterier.	m ¹	20.00	12.00 €	240.00 €
1.10.07	Furnizimi me material si dhe punimi, mveshjes së strehës me material aquapanel kualitativ për përdorim në ambiente të jashtme për gjatë gjithë perimetrit të objektit, zëvendësim për strehen ekzistuese nga materiali i drurit e cila duhet të demolohet. Punimi i strehës me akuapanel (knauf, apo e ngjajshme) duhet të përfshijë dhe konstruksionin adekuat të përcaktuar nga prodhuesi, si dhe trajtimi me rrjete, fasade adekuate dhe të gjitha shtresat me qëllim që të arrijë pamje identike me pjesën tjetër të fasades.	m ²	60.00	12.00 €	720.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.10					15,798.00 €

1.11	PUNËT E NDRYSHME				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH



1.11.01	Furnizimi me material dhe shtrimi i shtigjeve rreth objektit , para hyrjeve kryesore dhe parkingut te automjeteve te stafit me kubëza nga betoni i presuar me vibrim, tipi BEHATON, me dimensione 20x16 cm dhe trashësi t=8 cm, me sipërfaqe të parrëshqitshme, me dizajn të kombinuar me kubëza me ngjyrë natyrale të betonit dhe ngjyrë tjetër opcionale. Në çmim duhet të përfshihet: 1. Ngjeshja me makineri deri në arritjen e kompaktësisë Ms=80MPa 2. Shtresa e zhavorit 0-60 mm me trashësi 20 cm, 3. Shtresa e zhavorit 0-31 mm me trashësi 10 cm 4. Shtresa e zhavorit 4 - 8 mm me trashësi 5 cm dhe 5. Finalizimi me mbushjen e fugave. Kubëzat duhet të plotësojnë kushtet e qëndrueshmërisë ndaj ngricave, rezistencës ndaj shtypjes dhe lakimit, rezistenca në fërkim dhe gërryerje, qëndrueshmërinë ndaj ndikimit të kripërave për shkrirjen e akujve, të kenë stabilitet forme dhe të dimensioneve, të mos thithin ujin dhe veti tjera sipas standardit BS EN 1338:2000 në lidhje me elementet nga betoni i ngjeshur.	m ²	80.00	16.00 €	1,280.00 €
1.11.02	Furnizimi me material dhe kufizimi i shtigjeve rreth objektit dhe platove para hyrjeve kryesore me gurë skajorë nga betoni i presuar me vibrim, me dimensione 8x20x100 cm dhe ngjyrë natyrale të betonit duke përfshirë edhe punimin e bazamentit me beton. Gurët skajor duhet të plotësojnë kushtet e qëndrueshmërisë ndaj ngricave, rezistencës ndaj shtypjes dhe lakimit, qëndrueshmërinë ndaj ndikimit të kripërave për shkrirjen e akujve, të kenë stabilitet forme dhe të dimensioneve, të mos thithin ujin dhe veti tjera sipas standardit BS EN 1338:2000 në lidhje me elementet nga betoni i ngjeshur.	m'	95.00	9.00 €	855.00 €
1.11.03	Furnizimi me material si dhe trajtimi, sanimi i rrethojës metalike dhe derës për gjat gjithë perimetrit oborrit, në çmim përfshihet ngjyrosja me dy shtresa ngjyre adekuatë për përdorim në ambiente të jashtme. Lartësia e rrethojës eksituese është h=160 cm.	m'	100.00	3.00 €	300.00 €
1.11.04	Furnizimi dhe montimi i perdeve shiritore vertikale në të gjitha hapësirat e punës në objektin të shkolles. Materiali i perdeve duhet të jetë i trashë, i qëndrueshëm ndaj rezeve UV dhe të pastrohet lehtë. Ngjyra dhe tekstura e perdeve shiritore vertikale të përcaktohet në koordinim me organin mbikqyrës.	m ²	35.00	23.00 €	805.00 €



1.11.05	Te behet furnizimi me material, punimi dhe montimi i kuzhines nga materiali MDF me furnir bingu me trashesi $t=1.8$ cm, me dimensione 280x60x230 cm, ndarjet, hapsirat, hapjet dhe modelimi dhe perzgjedhja e ngjyres te behet ne koordinim me menagjerin e kontrates. Kuzhina duhet te permbaje te gjitha elementet e nevojshme duke perfshire edhe aksesoret adekuat per pozicionet perkatese. 	cope	1.00	900.00 €	900.00 €
1.11.06	Furnizimi dhe montimi i pllakes montuese per kuzhine, Qeramike me 4 sipërfaqe te ngrohjes, Niveli i gatimit 6, Lloji i pllakes të jet elektrike (Vitroçeramikë), ngjyrë e zezë dhe fuqi elektrike 5.8 kW, Përmasat: 56x5.5x49 cm. Tip HIC 64100 apo te ngjashme.	copë	1.00	150.00 €	150.00 €
1.11.07	Furnizimi dhe montimi i Furrë montuese, Multifunksionale, Klasa energjisë: A+, Kapaciteti: 71 L, 10 Funksione, Grill Ventilator, 4D pjekje, Paneli i kontrollit: Elektronik, Kohëmatës digjital. Funksioni: EcoClean Direct, Përmasat: 59.5x59.5x54.8cm	copë	1.00	175.00 €	175.00 €
1.11.08	Furnizimi dhe montimi i Frigoriferit me këto karakteristika: * Klasa energjisë: A+ * Kapaciteti neto: 252 L * Shpenzimet e energjisë: 132 kWh /vit * Përmasat: 145x54x61cm * Niveli i zhurmës: 39dB	copë	1.00	222.00 €	222.00 €
1.11.09	Furnizimi me material dhe rregullimi i pjesëve të parapara për gjelbrim duke përfshirë nivelizimin e dheut të ngjeshur, modelimin e terrenit, rikthimin e dheut të deponuar më parë, plehërimin, rrafshimin e sipërfaqes, mbjelljen me bar, deri në përgaditjen për mbjellje të luleve, shkurreve dekorative dhe drunjve të llojeve të ndryshme.	m ²	200.00	2.00 €	400.00 €
1.11.10	Demontimi i kaldajes egzistuese dhe pjeseve percjellese (flakehedhesit, qyngave, pompes etj), pastrimin e hapësirës ku ndodhet kalldaja dhe transporti deri ne deponinë e caktuar	komplet	1.00	100.00 €	100.00 €
1.11.11	Furnizimi dhe montimi i Kaldajes elektrike Qng=24 kW, Vaillant ose te ngjajshme	copë	1.00	780.00 €	780.00 €
1.11.12	Tubacioni dhe lidhja me sistem egzistues	komplet	1.00	125.00 €	125.00 €



1.11.13	Pastrimi i tërësishëm i objektit duke përfshirë pastrimin e pluhurit, pastrimin e dritareve, dyerve, dyshemeve dhe nyjeve sanitare me mjete higjienike dhe dezinfektuese nga brenda dhe jashtë duke përfshirë edhe pastrimin e parterit dhe përgaditja për pranm-dorëzim të objektit.	komplet	1	250.00 €	250.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.11					6,342.00 €


RENOVIMI I OBJEKTIT TE SHKOLLES EKZISTUES		
1.01	PUNËT PARAPREGADITORE	150.00 €
1.02	PUNËT E DEMOLIMIT	1,541.00 €
1.03	PUNËT E SUVATIMIT	540.00 €
1.04	PUNËT E NGJYROSJES	1,375.00 €
1.05	PUNËT E TERMOIZOLIMIT, NIVELIZIMIT DHE VESHJEVE TË DYSHEMESE	660.00 €
1.06	PUNËT E HIDROIZOLIMIT	150.00 €
1.07	PUNËT E QERAMIKËS PORCELANIT GRANITIT KUARCIT	2,533.00 €
1.08	PUNËT E ZDRUKTHTARISË DYERT, DRITARET DHE ELEMENTET TJERA	6,045.00 €
1.09	PUNËT E FASADËS	8,622.00 €
1.10	PUNËT E KULMIT TË PJERRËT DHE LLAMARINËS	15,798.00 €
1.11	PUNËT E NDRYSHME	6,342.00 €
Gjithsej totali me TVSH - PUNËT NDËRTIMORE		43,756.00 €

2	PUNËT E INSTALIMIT ELEKTRIK				
2.01	ELEKTRIKA				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
*Vërejtje: Objekti është egzistues keto pozicione janë për renovim.					
2.01.01	Furnizimi dhe shtrirja e kablos për furnizimin e KKSH (nga rjeti 0.4kV deri në KKSH, ne qmim perفشihet lidhja e kablrit ne ormanin e KEDS-it, XOO-A 4x25mm².	m'	30.00	6.00 €	180.00 €
2.01.02	Furnizimi dhe shtrirja e kablos për furnizimin e pompës termike NYM-J 5x6mm².	m	30.00	4.00 €	120.00 €
2.01.03	Furnizimi dhe montimi i ndërpersit magento termike AS 3p 80A/R63A 18kA.	copë	1.00	45.00 €	45.00 €



2.01.04	Furnizimi dhe montimi i shkruqesit e mbilensionit tip 1 40kA dhe sigures shkrirese 125A se bashku me baze.	set	1.00	65.00 €	65.00 €
2.01.05	Furnizimi dhe montimi me mbrojtje diferenciale FID 63/0.03A, 4P.	copë	1.00	45.00 €	45.00 €
2.01.06	Furnizimi dhe montimi i klemave shperndarese amocanali 150A.	set	1.00	125.00 €	125.00 €
2.01.07	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike 32A, 3P, C.	copë	2.00	35.00 €	70.00 €
2.01.08	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike 16A, 1P, C.	copë	2.00	35.00 €	70.00 €
2.01.09	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike 10A, 1P, C.	copë	5.00	32.00 €	160.00 €
2.01.10	Furnizimi dhe shtrirja e kablos NYM-J 5x2.5mm ²	m	20.00	4.50 €	90.00 €
2.01.11	Furnizimi dhe shtrirja e kablos NYM-J 3x2.5mm ²	m	20.00	3.40 €	68.00 €
2.01.12	Furnizimi dhe shtrirja e kablos NYM-J 3x1.5mm ²	m	500.00	0.90 €	450.00 €
2.01.13	Furnizimi dhe montimi i gypit të brinjezuar PVC Ø20mm.	m	600.00	0.12 €	72.00 €
2.01.14	Furnizimi dhe montimi i ndricuesit LED panel tip LED PANEL per montim ne blafon prej betoni (OG), 60x60cm, 40W, 4000lm, 4000K.	copë	34.00	35.00 €	1,190.00 €
2.01.15	Furnizimi dhe montimi i llampave Ndriques LED, OG, me poq led 12W për montim në ballkon, banjo, depo IP85, 1100lm, 4000K.	copë	4.00	33.00 €	132.00 €
2.01.16	Furnizimi dhe montimi i ndricuesit emergjente Rilux IP41 6W 1h Schneider electric	copë	7.00	24.00 €	168.00 €
2.01.17	Furnizimi dhe montimi i ndricuesit Ndriques LED linear 48W/3926lm, 4500K, IP65, l=1500mm, per montim direkt ne plafon nga muri.	copë	2.00	22.00 €	44.00 €
2.01.18	Furnizimi dhe montimi i llampave ndriquese per banjo, sensor te inkorporuar: LED Panel CAPRI 12W, IP44, 1240lm, 4000K, Ø200mm.	copë	2.00	18.00 €	36.00 €
2.01.19	Furnizimi dhe montimi i Ndriques reflektor me PIR sensor LED Canopy, 50W, IP66, 12000lm, 6400K, D=38x38cm, VT-9-477	copë	1.00	21.00 €	21.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 2.01					3,151.00 €

2.10	TOKEZIMI DHE RRUFEPRITESI				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
*Vërejtje: Objekti është egzistues dhe sistemi i tokzimit shfrytëzohet egzistuesi.					
2.10.01	Testimi i sistemit të tokzimit egzistues	pl	1.00	350.00	350.00
2.10.02	Furnizimi dhe montimi i shiritit të zinkuar FeZn 20x3 mm.	m	75.00	3.00	225.00



2.10.03	Furnizimi dhe montimi i mbajtësve të shiritit për montim në kulm S.	copë	75.00	2.40	180.00
2.10.04	Furnizimi dhe montimi i pranuesve të rufepritsit nga shiriti, FeZn 25x4 mm.	copë	5.00	3.00	15.00
2.10.05	Furnizimi dhe montimi i pllakave kryqzore për vazhdimin dhe kryqzimin e shiritave.	copë	25.00	4.00	100.00
	Furnizimi dhe montimi i gypave për tokzim (Sondave) 1.5m	copë	3.00	32.00	96.00
2.10.06	Material i imët.	pl	1.00	25.00	25.00
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 2.10					991.00 €

REKAPITULLIM		
2.01	ELEKTRIKA	3,151.00 €
2.10	TOKEZIMI DHE RRUFEPRITESI	991.00 €
Gjithsej totali me TVSH - PUNËT E INSTALIMIT ELEKTRIK		4,142.00 €

3	PUNËT E RRJETIT TË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT				
Në çmim njësi duhet të parashihet blerja, furnizimi, punimi/montimi i çdo materiali me pozicionim sipas projektit dhe testimi i materialeve para lëshuarjes ne pune. Sistemimi i materialeve, pastrimi i punishtes nga mbeturinat gjatë dhe pas kryerjes se punimeve. Për te gjitha materialet dhe produkte ndërtimore qe përdoren, paraprakisht te ofrohen certifikatat mbi kualitetin e tyre te cekura edhe ne pozicion. Materialet dhe produkte ndërtimore si dhënë ne pozicion nuk duhet te ndryshohen apo zëvendësohen pa aprovim nga projektuesi.					
3.01	PUNËT E UJËSJELLËSIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
3.01.01	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të ujësjellësit nga materiali Giacomini PE-X DIN 8077-78 EN ISO 1587 ne shtypje deri në 10bar. Në llogari të merren të gjitha pjesët fazonike, shtangueset (përforcueset për mure dhe tavane), lidhëse te ndryshme, gjysme lidhëset "T" lidhëse, kthesa 90°, "nipell, nipell i dyfishtë", reduktues, ventil, ventil me muf, ventil me holender etj. Tubat duhet te jene sipas standardit ISO 9001:2000 standardeve duke përfshirë edhe pjesët fazonike. Llogariten ne metër gjatësi.				
a	Ø25x4.4mm	m ¹	20.00	3.00 €	60.00 €
b	Ø20x3.5mm (uji i ftohtë)	m ¹	20.00	2.00 €	40.00 €
c	Ø20x3.5mm (uji i nxehtë)	m ¹	20.00	2.00 €	40.00 €
d	Ø16mm (uji i ftohtë)	m ¹	70.00	1.00 €	70.00 €
e	Ø16mm (uji i nxehtë)	m ¹	50.00	1.00 €	50.00 €




3.01.02	Furnizimi dhe montimi i kutive shpërndarëse nga Plastika (vendosen në murë dhe prej aty gypat shpërndahen deri tek njësia konsumuese të vendosen në lartësi prej 10-30cm); dim=LxHxB; 60x40x11cm. me te gjitha elementet percjellëse. Llogarite ne cope.	copë	1.00	15.00 €	15.00 €
3.01.03	Furnizimi transporti dhe montimi i vrimave te kolektoreve 3/4 me dalje 1/2".	copë	16.00	6.00 €	96.00 €
3.01.04	Furnizimi dhe montimi i lidhesave per Pex 16x2.0mm (24 x 19)	copë	16.00	6.00 €	96.00 €
3.01.05	Furnizimi dhe montimi i ventili sferik 3/4" me holender	copë	4.00	12.00 €	48.00 €
3.01.06	Furnizimi dhe montimi gjysemldhese kendore 3/4"	copë	16.00	4.00 €	64.00 €
3.01.07	Furnizimi dhe montimi i kokave perfundimtare plastike 105° me gjysemldhesen per Pex 16 x 2.0 mm dhe llamarinen distancuese.	copë	16.00	4.00 €	64.00 €
3.01.08	Furnizimi dhe montimi D.nipell Ø3/4	copë	4.0	8.00 €	32.00 €
3.01.09	Furnizimi dhe montimi Kthesave Ø3/4	copë	4.0	8.00 €	32.00 €
3.01.10	Shirit dhe gozha per perforcimin e gypave ne dysHEME.	copë	1.0	5.00 €	5.00 €
3.01.11	Tapa mbyltese 3/4 Filet e mbrendeshme.	copë	4.00	2.00 €	8.00 €
3.01.12	Furnizimi dhe montimi i ventilit sferik me holenderDN 25 ne kaseten kryesore. Llogaritet ne cope.	copë	1.00	12.00 €	12.00 €
3.01.13	Furnizimi dhe montimi i manometrit me rregullues te shtypjes Ø25mm. Llogaritet ne cope.	copë	1.00	35.00 €	35.00 €
3.01.14	Furnizimi dhe montimi i Bojlerit 80L me te gjitha elementet percjellëse. Llogaritet ne cope.	copë	1.00	120.00 €	120.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 3.01					887.00 €

3.02	UJËSJELLËSI I JASHTËM				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
3.02.01	Gërmimi i dheut për hapjen e kanalit të rjetit të ujesjellesit, nivelimi i kanalit pas gërmimit, vendosja e shiritit sinjalizues, mbulimi i kanalit me dheun e gërmuar me ngjeshja ne çdo 25cm, gërmimi te behet me thellësi +140cm sipas terrenit për vendosjen e gypave, ne llogari/çmimi te perfshihet mbulimi i kanalit me dheun e gërmuar te lartësisë se mbetur ne shtresa prej 30cmme ngjeshje përkatëse. Dheu i tepërt te barte ne dopninë e parapare nga investitori. Llogarite ne metër kub.	m ³	10.00	4.00 €	40.00 €



3.02.02	Furnizimi dhe vendosja e rërës nën gyp t=10cm, mbi gypin dhe rreth gypit t=25cm. Llogarite në metër kub.	m ³	5.00	15.00 €	75.00 €
3.02.03	Testimi i rrjetit para dhe pas mbushjes së kanalit.	komplet	1.00	25.00 €	25.00 €
3.02.04	Hapja e vrimave në mure sipas projektit dhe izolimi i tyre.	komplet	1.00	15.00 €	15.00 €
